



**STANDARDI  
GLOBAL  
PËR PËRGJEGJËSI TË  
ORGANIZATAVE TË  
SHOQËRISË CIVILE**



# 12 ANGAZHIME PËR PËRGJEGJËSI DINAMIKE

# ÇFARË ËSHTË STANDARDI GLOBAL?

Standardi global është standard referues që përfshin një kuptim të përbashkët në nivel global të përgjegjesisë dinamike.

Standardi është zhvilluar nga Iniciativat e Përgjegjesisë nga Afrika, Azia, Australia, Europa, Amerika e Veriut, Amerika Latine dhe Ishujt e Karaibeve.

Standardi global përfshin 12 angazhime të përgjegjesisë dinamike që organizatat e shoqërisë civile (OSHC) premtojnë të zbatojnë dhe mbi bazën e të cilave mund të përcaktohet përgjegjësia e tyre. Standardi përfaqëson një kornizë veçanërisht praktike që përshtatet me nevojat e ndryshme kulturore, gjeografike dhe organizative, nëpërmjet përdorimit të një gjuhe të thjeshtë pa zhargon dhe pa terminologji teknike. Me qasjen e thjeshtë dhe gjithëpërfshirëse, Standardi Global mundëson OSHC-të, pa varësisht nga madhësia apo fushëveprimi i tyre, të përmirësojnë praktikën e tyre të përgjegjesisë dhe rrjedhimisht edhe efektivitetin e tyre.

## KUSH MUND TA PËRDORË?

Standardin Global mund ta përdorin **Iniciativa të Përgjegjesisë** në mbarë botën për të harmonizuar standardet e tyre ekzistuese ose për të zhvilluar standarde të reja të përgjegjesisë. Standardi nuk synon të zëvendësojë iniciativat ekzistuese. Nëse kodet e përgjegjesisë në mbarë botën janë më mirë të koordinuara midis tyre, do të ketë krahasueshmëri më të madhe dhe kosto më të ulët të shkëmbimeve. Standardi Global mund të përdoret në bazë vullnetare si pike referimi nga:

- organizatat e shoqërisë civile, rrjetet e organizatave të shoqërisë civile dhe grupet e përfaqësimit për përmirësim të standardeve dhe praktikave të tyre për përgjegjësi
- qeveritë dhe donatorët me qëllim krijimin e normativave mundësuese dhe politikave për financimin e organizatave të shoqërisë civile
- palët e interesuara që të mund të kërkojnë përgjegjësi nga OSHC-të dhe
- organizatat e shoqërisë civile për të mundësuar krijimin e partneriteteve efektive

## #PËRGJEGJËSIDINAMIKE

Termi përgjegjësi dinamike, i zhvilluar nga organizata Restless Development, përshkruan çfarë domethënë të jesh OJF e përgjegjshme, të punosh në menyrë transparente me palet e interesuara dhe të mësosh prej tyre me qëllim rritjen e ndikimit dhe efektivitetin e organizatës. Ky kuptim dinamik i përgjegjesisë që i vendos njerëzit në qendrën e procesit të marrjes së vendimeve është thelbi i Standardit Global.

Qëllimi i Standardit Global është të jetë pikë fillestare për një lëvizje globale ku përgjegjësia dinamike është

në fokus duke paraqitur një kornizë përmes së cilës do të zbatohen qëllimet dhe vlerat e përbashkëta që bashkojnë organizatat e shoqërisë civile në mbarë botën. Nëse mijëra organizata e praktikojnë qasjen dinamike të përgjegjesisë, ai ka potencial ta transformojë tërë sektorin e shoqërisë civile në një aktor shumë të përgjegjshëm që i përfshin të gjitha palët e interesuara, krijon besim dhe e përdor kontributin e tyre për të patur një ndikim më të madh.

Ekipi i Standardit Global është i etur për të dëgjuar mendimin tuaj, ju lutemi të na kontaktoni për të mësuar më shumë për Standardin Global dhe se si mund të përfshihenit në aktivitetet tona! [feedback@csostandard.org](mailto:feedback@csostandard.org)